



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Genc Pollo – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 28.01.2019
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit European në Republikën e Shqipërisë”.
3. Të tjera

Marrin pjesë:

Genc Pollo, Senida Mesi, Mirela Kumbaro, , Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Aldo Bumçi, Grida Shqina, Jorida Tabaku, Kejdi Mehmetaj, Musa Ulqini, Sadri Abazi dhe Viktor Tushaj.

Mungojnë:

Taulant Balla, Vangjel Dule, Fatmir Velaj

Të ftuar:

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Silvana Dervishi – Përfaqësuese e Sektorit të Marrëveshjeve në Ministrinë e Brendshme

Renata Balliu – Përfaqësuese e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Brendshme

Tomorr Duro – Përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Genc Pollo – Të nderuar kolegë deputetë, fillojmë mbledhjen e komisionit tonë sipas rendit të ditës, për të cilin kemi rënë dakord. Kryesor në mbledhjen e sotme është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes...” statutore do të thosha unë, jo statusore “...ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit European në Republikën e Shqipërisë”. Prezentë kemi përfaqësues nga Ministria e Brendshme: zonjën Rovenë Voda, zëvendësministre, bashkë me kolegët e saj, si zonjën Dervishi nga Sektori i Marrëveshjeve, zonjën Balliu nga Drejtoria Juridike dhe zotin Duro nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit.

Mirë se keni ardhur!

Para se të hyjmë në rendin e ditës, në vijim të diskutimeve dhe shqetësimeve që u ngritën mbledhjen e kaluar, në Konferencën e Kryetarëve unë ngrita shqetësimin se projektligjet që kanë të bëjnë me *acquis*, pra me legjislacionin european, duhet patjetër të kalojnë për dhënie mendimi në komisionin tonë, çka nuk ka ndodhur në dy raste.

Kryetari i Kuvendit insistoi pranë stafit që të shqyrtohej në mënyrë të veçantë dhe me vëmendje çdo projektligj i ardhur, qoftë edhe nga qeveria, por edhe i iniciuar nga deputetët, pasi në fillim të legjislaturës kemi pasur disa raste kur nismat ligjore të deputetëve preknin *acquis*-në dhe, fatkeqësisht, nuk iu kaluan komisionit tonë për mendim. Ndërsa për çështjen që u diskutua këtu, për ligjin e posaçëm për ndërtimin e aeroportit të Vlorës, ligji tashmë ka hyrë në fuqi dhe në Konferencën e Kryetarëve nuk e gjetëm dot menjëherë zgjidhjen, pra u la për t’u shqyrtuar më vonë se si ne mund të krijojmë një mendim në vijim të shqetësimeve që janë bërë edhe publike nëse ky ligj përshtatet ose jo me *acquis communautaire*. Zgjidhjen nuk e kemi ende gati, por si zonja Tabaku, e cila e ngriti çështjen, edhe ne të tjerët, që e kemi diskutuar, do t’i shikojmë mënyrat bashkë me nënkryetaren, me të cilën e kam biseduar, për të gjetur një zgjidhje.

Thënë kjo, mendoj se tani mund të kalojmë te rendi i ditës: kemi miratimin e procesverbalit, që besoj e keni parë dhe me të cilin jemi dakord, si dhe shqyrtimin e projektligjit për prezantimin e të cilit do t’ia jepja fjalën zonjës zëvendësministre.

Rovena Voda – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e thatë edhe ju në fjalën tuaj hyrëse, sot jemi këtu për të prezantuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes statutore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit European në

Republikën e Shqipërisë”. Në fakt, projektligji parashikon ratifikimin e kësaj marrëveshjeje statutore, e cila synon rritjen e nivelit të bashkëpunimit të vendit tonë me vendet e BE-së, në kuadrin e menaxhimit të kufijve dhe emigracionit të paligjshëm, si dhe gjatë zhvillimit të operacioneve të kthimit dhe ripranimit; pjesëmarrjen në operacione të përbashkëta dhe trajnime; rritjen e nivelit profesional të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e detyrave dhe të kompetencave për menaxhimin dhe zgjidhjen e situatave; rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin e informacionit, si dhe krijimin e mundësisë për përdorimin e aseteve teknike e logjistike edhe në kufijtë e vendit tonë, në rastet e mundshme të flukseve të mëdha migratore, të papërbalueshme me kapacitetet njerëzore dhe teknike të vendit tonë.

Kjo është marrëveshja në thelb. Por pse është e rëndësishme për Shqipërinë? Sigurisht, në kuadër të integritetit europian dhe këtu jemi në komisionin që, si të thuash, është përgjegjës dhe mbulon këtë pjesë, është e rëndësishme, pasi ka qenë një nga marrëveshjet apo një nga detyrat që vendet e BE-së kanë lënë, si të thuash, për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, e thënë kjo qartë në strategjinë e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor për hapjen e negociatave në shkurt të vitit 2018. Pra, vitin e kaluar Bashkimi Europian doli me një strategji për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku një nga pikat kryesore ose një nga detyrimet e ka qenë edhe nënshkrimi ose ratifikimi i kësaj marrëveshjeje me FRONTEX-in, po e përmbledh shkurtimisht, sepse vetë Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufitare është FRONTEX-i, por i ka ndryshuar emri dhe i janë zgjeruar disa kompetenca, në bazë të rregullores së këshillit të vitit 2016.

Në këtë kuadër, duke qenë se Ministria e Brendshme është, gjithashtu, përgjegjëse edhe për kapitullin 24 “Liria, drejtësia dhe siguria”, kjo marrëveshje vjen në përputhje me parimet e këtij kapitulli, në përputhje edhe me planin kombëtar të integritetit europian. Kështu që besoj se është një vlerë e shtuar dhe patjetër një detyrim i përmbushur nga qeveria shqiptare në procesin e hapjes së negociatave.

Por dua të theksoj një gjë. Kjo nuk është një marrëveshje tip, pra vetëm për Shqipërinë, por ka qenë një marrëveshje statutore e propozuar për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim menaxhimin kryesisht të emigracionit të paligjshëm, flukseve migratore në kufijtë e jashtëm të BE-së, ku Shqipëria, siç e dimë, ndan dy kufijtë e saj, pra në vende të BE-së, Greqinë dhe Italinë.

Unë mendoj se ratifikimi sa më shpejt i kësaj marrëveshjeje do të jetë një vlerë e shtuar në menaxhimin e integruar të kufijve të Shqipërisë.

Me pak fjalë, ky është prezantimi. Nëse do të ketë pyetje, jam e hapur t'u përgjigjem.
Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Besoj se edhe komisioni ynë i shqyrton me përparësi dhe në mënyrë pozitive marrëveshjet me Bashkimin Europian. Po i filloj unë pyetjet dhe pastaj nga Njësia e Përafrimit në Kuvend mund të dëgjojmë opinionin e tyre lidhur me përputhshmërinë ligjore, me çështjet e kufirit, që janë të ndjeshme.

Ju thatë që kjo marrëveshje bëhet për situatat eventuale në të ardhmen të flukseve të mëdha migratore, të cilat Policia Kufitare dhe agjencitë e tjera të sigurisë të Shqipërisë mund të mos jenë në gjendje t'i përballojnë ose të paktën jo siç duhet.

Duke thënë këtë, ky do të ishte një prezantim i arsyeshëm, por kemi parasysh që kur themi “integrim europian”, do të thotë që duhet të arrijmë disa standarde të Europës, në mënyrë që të bëhemi të pranueshëm për ta. Prandaj vjen shpesh si debat, por kemi pasur diskutime edhe në seancë plenare, sepse nga ministrat e qeverisë, si ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, asokohe zoti Bushati, po edhe të tjerë, faktin se në vendin tonë, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me Bashkimin Europian ose bilaterale me shtete të caktuara të Bashkimit Europian e më gjerë, vijnë agjentë policorë, vijnë oficerë ndërlidhjeje (*liaison officer*) e shikonte si një hap drejt integritetit. Në fakt, nga ana konceptuale është e kundërta, sepse për shkak të dobësisë së organeve tona shtetërore detyrohemi t'i kërkojmë ose t'i ftojme, pasi na kanë sugjeruar që të bëjmë ftesën, që të kemi një prani të shtuar të huaj, për arsye se organet tona, duke filluar nga policia, e cila ka pasur gjithë ato probleme të debatuar gjerësisht në seancat plenare, ka qenë e pamundur dhe e paafte për të zgjidhur sfidat dhe detyrat që i ngarkon ligji. Kjo nuk ka të bëjë me bashkëpunimin normal ndërmjet dy vendeve, bashkëpunimin ndërmjet policive në një moment ose në një periudhë, ku krimi është transnacional dhe transkufitar, por ka të bëjë me situatat e brendshme dhe kemi një prani, e cila nuk do të ishte normale sikur Shqipëria të ishte një shtet funksional. Ky ka qenë pak a shumë debati dhe ideja që ne bashkohemi, ne i ftojme, të na shikojnë çdo hap. Ky është më tepër një pranim direkt dhe indirekt i dobësisë së shtetit tonë, sesa një hap drejt integritetit europian, sepse ky integrim nuk ka aspak këtë kuptim në konceptin fillestar të tij.

Megjithatë, në rastin e flukseve migratore, si ato që janë verifikuar vitet e kaluara, kjo është e kuptueshme, por me sfidat që ka kufiri ynë me kontrollin e njerëzve dhe jo vetëm të emigrantëve në valë të mëdha, por edhe të personave të padëshiruar për arsye të sfondit kriminal, terrorist e të tjerë, kjo besoj se do të ishte sfida më e madhe. Ndoshta në prezantimin

që ju do të bëni mund të na sqaroni si mund të ndihmohemi në këtë pikë nga prania e shtuar e Agjencisë së Rojës Bregdetare dhe Kufirit European, ish-Frontex-i.

Gjithsesi, kjo ishte një vërejtje fillestare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, flisni ju një herë, pastaj do ta marrë fjalën përfaqësuesi i Njesisë së Përafrimit.

Rovena Voda – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua të kthehem pak në kohë, te marrëdhënia jonë me FRONTEX-in. Në fakt, kjo nuk është një marrëdhënie e re me Frontex-in dhe nuk ka asgjë të re, por absolutisht e ngre bashkëpunimin në një stad më të lartë.

Marrëveshjen e parë me FRONTEX-in ne e kemi pasur të nënshkruar në datën 19.02.2009 dhe atëherë, me sa di unë, nuk kemi mbajtur këtë qëndrim, pra nuk është thënë: “Obobo, na erdhi FRONTEX-i dhe çfarë po ndodh në vitin 2009 në Shqipëri?!”. Me sa mbaj mend, jo.

Pse them që është vlerë e shtuar? Sepse të bashkëpunosh me FRONTEX-in, duhet të kesh të njëjtat procedura, standarde operuese, çka do të thotë se duhet të kesh të njëjtin nivel operacional; do të thotë se nuk mundet FRONTEX-i të shkojë tani dhe të punojë me oficerët e kufirit, pa paragjykuar, se po marr emra shtetesh, në Siri, në Afganistan, në Kazakistan e të tjerë. Kjo nuk është e mundur, ndërkohë që policia jonë ka një marrëdhënie shumë të mirë me Frontex-in, e cila daton që nga viti 2009, dhe për këtë më vjen shumë mirë, por kësaj here kjo vjen e ngritur në një stad më të lartë.

Më vjen keq të them se nuk jam dakord me logjikën tuaj: “Shiko, se ka dobësi shumë të mëdha, prandaj FRONTEX-i vjen këtu”. Absolutisht, ne nuk jemi më të mirët në Ballkan, as më të mirët në Europë, por Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit European është një agjenci që vepron ndërmjet vetë vendeve të BE-së, ju e dini këtë, është krijuar vite më parë, por i ka ndryshuar vetëm emri me rregulloren e re të këshillit në vitin 2016. Kjo do të thotë se, nëse nisemi nga kjo logjikë, kaq të dobët kanë qenë kufijtë e shteteve anëtare, si: Italia, Gjermania, Franca, Belgjika, që arritën dhe krijuan këtë agjenci? Sigurisht që jo. Nuk ka perfeksion në agjencitë ligjzbatuese, si kudo tjetër, por ndarja e informacionit, ajo që thatë ju, me përballjen e fenomenit të krimit transnacional, është e pamundur të luftohet apo të menaxhohen situata të caktuara brenda një territori të izoluar.

Edhe për sa i përket migracionit, besoj se këtë mendim e ndajnë të gjithë deputetët këtu në komision, ai ka qenë një nga sfidat e BE-së; një nga shtyllat kryesore.

Në të gjitha presidencat e fundit që kanë pasur vendet e BE-së, si prioritet kanë vënë po ta shikoni, *European Citizen Security*, pra sigurinë e qytetarëve europianë dhe, e dyta, ka qenë *Migration* (migracioni), sepse është sfidë dhe në flukset migratore sigurisht që ka potencial edhe të krimit ndërkufitar. Pa diskutim, ka potencial edhe për aktivitet terrorist, edhe për terrorizëm, por kjo nuk do të thotë se vendet e BE-së nuk kishin një polici të mirë kufitare, me kapacitete logjistike, me burime njerëzore. Por vetëm nëpërmjet bashkëpunimit, nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, shkëmbimit të informacionit, planeve të përbashkëta operacionale, ne, si Europë (sepse Shqipëria është vend i Europës, pavarësisht se nuk është pjesë e BE-së) mund t'u bëjmë ballë këtyre fenomeneve, që përbëjnë një kërcënim jo vetëm për BE-në, por për të gjitha vendet.

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit, por do të bëj edhe një shtesë!

Me fjalë të përgjithshme, është shumë e vështirë të mos biem dakord, por le t'i qëndrojmë thelbit. Sipas kësaj marrëveshjeje, agjentët e FRONTEX-it, pra të Agjencisë së Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian, marrin kompetenca që, në rast se, me lejen përkatëse, të kryejnë detyra operacionale të armatosur. Kjo, me sa di unë, më korrigjoni nëse jam gabim, nuk ndodh me Italinë, nuk ndodh me Spanjën, që kanë sfida të ngjashme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë, te ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta edhe në vende të tjera të Ballkanit, por fakti që ndodh në këtë mënyrë është konfirmim direkt në nivel traktati i dobësive inerente dhe dobësive të shtuara që kanë organet tona.

Megjithatë, të mos zgjatemi shumë, se edhe kolegët... Besoj se është çështje me rëndësi, por pavarësisht nga kjo, mendoj se është një marrëveshje bashkëpunimi me interes.

E kanë kërkuar fjalën zonja Gjoshë, zoti Bumçi, zonja Tabaku, zoti Tushaj dhe zonja Mesi.

Klajda Gjoshë – Përshëndetje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo – Po vijojmë me pyetjet nga anëtarët e komisionit. Nganjëherë i bëjmë pyetje-diskutim, por jemi në pyetje si rend.

Klajda Gjoshë – Nuk ka problem, pyetje do të bëj, pavarësisht se brenda ka edhe pak diskutim.

Unë ju falënderoj që e sollët sot këtë marrëveshje! Është e padiskutueshme se është një marrëveshje me shumë rëndësi edhe në kuadrin e procesit të integritetit, edhe të kapitullit 24, që ka një rëndësi të veçantë në këtë proces, por është vetëm fillimi. Këtu thotë: “firmoset marrëveshja”, pavarësisht se pikëpyetjet e mia vijnë më pas: sesi i implementojmë ne marrëveshjet dhe se si do të raportohet për të gjithë ecurinë e kësaj marrëveshjeje në ditët dhe muajt në vijim. Sepse njëra anë është të firmosim disa letra, dhe ne jemi mësuar, madje në përgjithësi mbahemi për shumë letra të shkruara bukur, por implementimi është ndryshe.

Unë kam një pyetje. Nuk e vë në diskutim nevojën që kemi ne për bashkëpunimin me Frontex-in e me radhë, por kam një pyetje për ju, si përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme: sa është numri i azilkërkuesve sot në vendet e Bashkimit Europian? Nuk e di, a keni bërë ndonjë analizë të shkaqeve të largimit të qytetarëve shqiptarë nga Shqipëria, ligjërisht ose jo? Pra, a është bërë një analizë e thellë nga ju dhe nga qeveria shqiptare për ta ndaluar pikërisht këtë fluks të madh qytetarësh që largohen nga vendi, duke ju rikujtuar se në qershorin e vitit 2018 këshilli i ka rekomanduar pikërisht Komisionit Europian të dalë me një raport të posaçëm për azilkërkuesit? Ky do të jetë një raport i cili do të jetë komplementar me raportin e vitit që do të paraqitet për Shqipërinë, në mënyrë që kjo e fundit të çelë negociatat. Ndaj, unë besoj se me shumë rëndësi këtu sot ka diskutimi për këtë çështje.

Faleminderit!

Genc Pollo – Po, zoti Bumçi.

Aldo Bumçi – Unë kam koment dhe një pyetje, por kryesisht është koment.

Së pari, ju përmendët se kemi pasur marrëveshje në vitin 2009, ndërsa kjo vjen si marrëveshje e re e përmirësuar. Me sa kam dijeni, kjo marrëveshje është tërësisht ndryshe nga ajo e vitit 2009, sepse lejon që ato të veprojnë si polici shqiptare këtu, u lejohej të mbajnë armë, mund të veprojnë në mënyrë ekskluzive në emër të Shqipërisë në territorin e saj në rast se autorizohen dhe nuk ka roje kufitare, por ato veprojnë si policia shqiptare, pra përdorin armët, municionet, arrestojnë dhe kryejnë të gjitha veprimet operationale; përdorin bazat e të dhënave kombëtare, si policia shqiptare, për të kryer operationet dhe kanë imunitet civil dhe penal për të gjitha pasojat që sjellin gjatë këtyre aksioneve. Pra, me këtë marrëveshje, në njëfarë mënyre, vendoset dështimi i shtetit shqiptar në kontrollin e territorit.

Argumenti juaj se këtu kemi të bëjmë me flukse migratore dhe prandaj po bëhet, nuk qëndron aspak. Në vitin 2015, sado që viti 2016 ishte viti kur kulmoi kriza e emigrantëve, Shqipëria u anashkalua nga flukset migratore, të cilat ishin të papërfillshme në territorin shqiptar. Kaluan në Greqi, në Maqedoni, Serbi dhe Hungari, pra e anashkaluan vetë Shqipërinë.

Arsyet e anashkalimit ishin të shumta, ndoshta ishte mungesa e infrastrukturës për të kaluar, nuk donin të përdornin detin, sepse Mesdheu u kthye në një varrezë të madhe, por përdornin përsëri detin nga Vlora. Madje në Vlorë u bënë gati. Në zonën elektorale të Kryeministrit, infrastruktura e krimit të organizuar u bë gati për të shkuar në Itali, ndërkohë që flukset migratore nuk e përdorën Shqipërinë.

Atëherë, kur këto flukse nuk e përdorën Shqipërinë, për çfarë arsyeje po vijnë sot? Sepse logjika do të ishte që kjo marrëveshje të bëhej me Maqedoninë, me Serbinë. Por nuk ka marrëveshje të tillë.

Ju thoni se është marrëveshje tip, që është bërë edhe me vende të tjera. Unë nuk kam asnjë informacion që kjo marrëveshje, siç po diskutohet sot në parlamentin shqiptar, të diskutohet në parlamentin maqedonas, në parlamentin serb, edhe pse ato vende u përballën me një fluks migrator të jashtëzakonshëm, që shkonte në Hungari e më tej në Austri dhe Gjermani.

E para, edhe një herë, argumenti se kemi të bëjmë me flukse migratore nuk qëndron, pasi Shqipëria nuk ka flukse migratore.

E dyta, kjo marrëveshje nuk është nënshkruar me vendet që kanë pasur flukse migratore.

E treta dhe e fundit, këtu kemi të bëjmë me dështimin e Shqipërisë, me azilkërkues, ku numrat për frymë janë më të lartët në Europë, nuk ka asnjë vend tjetër, janë rreth 200 mijë azilkërkues nga një komb prej 2,9 milionë banorësh.

Jo të gjithë ata që janë në Europë janë regjistruar si azilkërkues, ke edhe qindra, mijëra të tjerë, që qëndrojnë në shkelje të rregullave të Shengenit pa u regjistruar si azilkërkues, ke problemet e fëmijëve të braktisur, si dhe krimin e drogën.

Shqipëria, siç e thonë raportet e Europolit dhe të *State Department*, është furnizues kryesor me kanabis i Europës, portë kryesore hyrëse e drogave të forta të llojit heroinë dhe kokainë, si dhe bazë operationale e krimit të organizuar rajonal.

Për të gjitha këto arsye në Shqipëri po vjen Frontex-i me pjesëmarrës nga vendet anëtare të Bashkimit European, që kanë fuqi operationale. Kjo gjë nënkupton dështimin e Shqipërisë.

Kam edhe një pyetje për të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Jo, thjesht të bëjmë një krahasim.

Në vitin 2010 u liberalizuan vizat. A do të kishte ndodhur ndonjëherë ai akt nëse Shqipëria do të ishte në kushtet e sotme? Nëse në vitet 2009-2010 Shqipëria do të ishte

furnizuesja kryesore e Europës me kanabis, portë hyrëse e kokainës dhe heroinës, bazë operacionale e krimit të organizuar, a do të ishte e nevojshme të vinte policia europiane për të arrestuar apo për të vepruar si polici shqiptare? Vizat nuk do të ishin liberalizuar kurrë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse ju thoni që e sjell koha. Çfarë është stabilizuar në kohën e Partisë Demokratike, pra të qeverisjes sonë? Ju thoni se e solli koha. Por koha nuk ka sjellë asgjë. Kanë qenë 125 kërkesa, të cilat u plotësuan bashkë me sistemin TIMS, MEMEX dhe 123 kërkesa të tjera, që u liberalizuan vizat dhe sot shqiptarët e marrin të mirëqenë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me kushtet që ka sot Shqipëria, falë qeverisjes së Edi Ramës, është pikërisht kjo marrëveshje. Ai ka thënë se do të bëjë shtet, ndërkohë që sot policia europiane vjen në Shqipëri që të funksionojë si polici. Ky dështim nuk do ta kishte arritur kurrë liberalizimin e vizave po të kishim qenë në kushtet që jemi sot; kurrë!

Faleminderit!

Genc Pollo – Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – E dëgjova zëvendësministren, por nuk arrita të marr asnjë informacion përmbajtësor në lidhje me marrëveshjen: sa agentë do të jenë, si do të organizohen, cili është territori ku do të ushtrojnë aktivitetin e tyre apo edhe nëse kemi informacione në këtë fazë si do të organizohet mbështetja e Agjencisë së Kufirit.

Zëvendësministrja përmendi Strategjinë e Zgjerimit, të cilën ne të gjithë këtu, si anëtarë të Komisionit për Integrimin European, e kemi lexuar me shumë interes. Në fakt, Strategjia e Zgjerimit, e publikuar në shkurt, ishte një udhërrëfyes shumë i mirë për vendet anëtare për të filluar për të marrë masa, konkretisht për të krijuar një plan pune për të zbatuar një pjesë të rekomandimeve. Shikoj që qeveria shqiptare e ka miratuar vendimin në datën 16. 05. 2018, por e ka sjellë për t'u diskutuar tani në parlament. Pse ka ndodhur vonesë?

Së treti, edhe komisioneri kur erdhi këtu herën e kaluar, por njëkohësisht shumë nga ne që takojmë përfaqësues të vendeve anëtare, si nga Gjermania ashtu edhe nga Holanda, kanë një shqetësim të jashtëzakonshëm për numrin e kërkesave për azil. Është në deklaratën e tij dhe në çdo deklaratë që kanë bërë vendet anëtare, është në shqetësimet që ka kryesisht Gjermania për hapjen e negociatave.

I bashkohem pyetjes dhe shqetësimit që ngriti zonja Gjoshë. Sa nga kërkesat për azil janë në këtë kategori dhe çfarë masash po merr qeveria shqiptare për këtë gjë?

Ne kemi informacion, ashtu siç e marrim të gjithë nga EUROSTAT-i, për kërkesat vjetore për azil dhe sa janë rritur ato. A ka qeveria shqiptare një strategji dhe një plan për adresimin e kësaj? Pjesa më e madhe e tyre varen nga shkaqe ekonomike dhe nga një situatë e përgjithshme që vjen nga qeverisja, faktor që nuk lidhen me Ministrinë e Brendshme. Në kuadrin e dhënies zgjidhje të këtij prioriteti, çfarë po bën qeveria shqiptare për ta adresuar këtë shqetësim? Paralelisht me shqetësimin për vendosjen e kësaj agjencie ose bashkëpunimin me këtë agjenci, sigurisht që lidhen edhe problemet e krimit. A ka Ministria e Brendshme një plan pune për të adresuar një nga prioritetet e tjera që ne kemi në kuadrin e integritetit evropian për krimin e organizuar?

Ne i kemi ndjekur me shumë shqetësim raportet e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për rritjen e krimit të organizuar për faktin që tashmë Shqipëria është kthyer në një port dhe urë lidhëse për rajonin për trafikimin jo vetëm të drogërave të lehta, por edhe për drogat e rënda. Çfarë plani pune ka qeveria shqiptare për këtë?

Ne si komision mbetemi në pritje që Ministria e Brendshme të na sjellë informacion për prioritetet që ajo ka për të zbatuar dhe për të plotësuar. Besoj se do të kemi një diskutim më të gjerë për të. Sjellja e kësaj marrëveshjeje mund të jetë një bazë për të filluar dhe për të pyetur, sepse lidhen edhe me shqetësimet dhe rekomandimet e BE-së.

Genc Pollo – Fjalën e ka zoti Duzha. Më pas mund t’u përgjigjeni pyetjeve.

Luan Duzha – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të falënderoj zonjën Voda për informacionin që dha, por edhe kolegët për të gjitha shtesat që i bënë informacionit që i dhanë kolegëve të Komisionit të Integritetit.

Unë vazhdoj të besoj se në Komisionin e Integritetit ne jemi për përafrimin e legjislacionit me Bashkimin Evropian, por vazhdoj t’i mëshoj idesë se përveç përafrimit të legjislacionit, ne jemi për të ndikuar që përmes përafrimit të legjislacionit të ndikojmë në përafrimin e standardeve. Nëse nuk përafrojmë standardet me Bashkimin Evropian, përsëri ne do të jemi shumë larg.

Unë jam i bindur se me të gjitha problemet që Shqipëria ka, jemi ne problem për Europën dhe jo Europa për Shqipërinë. Padyshim që kjo marrëveshje do të ndikojë në rritjen e parametrave përmes trajnimeve të ndryshme të anëtarëve të agjencisë së rojës bregdetare dhe të kufirit në rritjen e profesionalizmit të tyre, por do të doja të dija nëse përmes këtyre veprimeve operationale që do të bëjë kjo agjenci në bashkëpunim me FRONTEX me Bashkimin Evropian, do të ndikojë vetëm te shqetësimi që ka Europa për Shqipërinë për Emigracionin apo edhe për krimin e organizuar edhe për trafikun e drogave që bëhet nga

Shqipëria? Pra, për të ruajtur vijën bregdetare apo kufijtë e Republikës së Shqipërisë. Është një shqetësim i jashtëzakonshëm edhe për Europën, por në mënyrë të veçantë për këto standarde të ulëta që ka Shqipëria sot në sytë e të gjithë Europës.

Padyshim bashkohem edhe me shqetësimin e kolegut Bumçi, që nëse Shqipëria do të kërkonte sot liberalizimin e vizave, absolutisht, për shkak të gjithë këtyre problematikave që ka, nuk do të ishin liberalizuar. Kështu që, kjo është një kampanë alarmi për qeverinë, qeverisjen, ministrinë e Brendshme por edhe për Agjencinë e Rojës Bregdetare pikërisht për të rritur efikasitetin e kontrollit të kufijve të Shqipërisë dhe të gjithë bregdetit në mënyrë të veçantë.

Faleminderit!

Grua – Përsëritje të gjithëve!

Meqë seanca po zhvillohet me pyetje dhe diskutime, në këtë linjë po vazhdoj edhe unë.

Zonja Zëvendësministre, të falënderoj për përshkrimin!

Faktikisht, kjo është një marrëveshje standard. Po ta shikosh edhe nga ana e përkatimit, në fund fare thuhet që kjo është një kopje identike e hartuar në 15 apo 20 gjuhë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Gjej rastin të shpreh gjithmonë falenderimet për Bashkimin Europian dhe zyrën e delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri për të gjithë mbështetjen jo vetëm për këtë marrëveshje, por të gjithë mbështetjen që në rastin konkret bashkë me ministrinë e Brendshme ka kontribuar jo vetëm në ruajtjen e kufijve, por në çdo ekspertizë për rritjen e sigurisë në rajon, por edhe më gjerë.

Kjo është një nga ato marrëveshjet standarde për të cilën do të doja nga zëvendësministrja të thoshte diçka në lidhje me detajimin, kur theksohet plani operacional, i cili duhet të ndërtohet patjetër me praninë e të dyja palëve. Në këtë plan operacional pyetja imje konkrete është: Do të jetë me kërkesë të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme vetëm për rastet e evidentuara apo një plan operacional që përgatitet paraprakisht për një periudhë disamujore ose të gjithë vitin, apo për raste specifike me marrjen e informacioneve të rëndësishme ku kërkohet edhe suporti i agjencisë respektive?

Faktikisht, po hyj në një proces shumë të rëndësishëm. Bashkëpunimin me organizata dhe me agjenci të tilla unë e shikoj pozitive dhe jo negative sikurse e shikon opozita, pasi gjithmonë ne po duam të aderojmë pranë një vendi, i cili ka vite shtetformim, ekspertizën e duhur dhe informacionet e duhura për të na shërbyer ne si Republikë e Shqipërisë për të qenë aty ku janë sot vendet anëtare të Bashkimit Europian. Nëse do të kishte qenë e kundërta, ne

nuk do të hynim në asnjë marrëveshje të tillë. Do të ishim pothuajse gati të kërkonte Europa të hynte në Shqipëri dhe jo Shqipëria të hynte në Europë.

Kështu që unë përgëzoj çdo marrëveshje të kësaj natyre në kuadër të ndihmës që Bashkimi European dhe vendet e Bashkimit European i japin Shqipërisë, sidomos në lidhje me rritjen e ekspertizës, trajnimit të stafit, shkëmbimin e informacioneve, për të bërë të mundur që edhe Republika e Shqipërisë dhe institucionet përkatëse të kenë informacionin dhe ekspertizën e duhur me qëllim që të përballojnë jo vetëm flukset emigratore, por çdo problematikë tjetër në lidhje me rritjen e sigurisë në vend dhe në rajon.

Faleminderit!

Rovena Voda – Faleminderit, kryetar!

Po e filloj nga pyetja e parë, kur do të bëhet implementimi dhe diçka për azilkërkimin.

Për implementimin e kësaj marrëveshjeje është parashikuar që do të nënshkruhet një marrëveshje pune, që do të vendosë standarde të përcaktuara qartë, e cila do të kalojë me vendim të Këshillit të Ministrave. Mbi bazën e asaj marrëveshjeje pune, ku do të ketë rregulla të qarta dhe të përcaktuara, do të krijohet edhe baza për të hartuar më pas plane operacionale, të cilat nuk do të jenë plane operacionale 1-vjeçare apo 6-mujore, por rast pas rasti. Planet operacionale do të bëhen gjithmonë me propozimin dhe me miratimin e Policisë Kufitare dhe të Migracionit. Pra, jemi në të parët. Marrëveshja e punës do të jetë marrëveshje standard, ashtu siç kanë edhe vetë vendet e BE-së për këtë agjenci ndërmjet njëra-tjetrës. Na është propozuar nga FRONTEX, sepse jemi me drejtuesit kryesor të FRONTEX-it...

Unë vetë kam takuar zëvendës drejtorin e FRONTEX, zotin Berndt Korner, i cili, në fakt, ka qenë dikur ekspert i PAMECA-s dhe ka punuar në Shqipëri dhe më ka thënë fjalët më të mira për sa i përket profesionalizmit të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Në zhvillimet e fundit në legjislacion për sa i përket kontrollit kufitar po shikohet mundësi ...

Kroacia ka një marrëveshje shumë të mirë pune me FRONTEX-in. Pra, po shikojmë një model të mirë, i cili do të shërbejë si bazë dhe do të kalojë me një akt. Sigurisht, më pas komisioni mund të interesohet për implementimin. Pra, ne nuk duam thjesht të bëjmë gjëra në letër. Këtu unë pajtohem me zonjën Gjoshë. Absolutisht nuk do të jetë kështu.

Për sa i përket azilkërkimit, në fakt, çështja e azilkërkimit nuk lidhet me këtë marrëveshje, por unë do të përgjigjem përpara jush, të nderuar deputetë, sepse jam zëvendësministre e Ministrisë së Brendshme. Unë thashë që fokusi kryesor i kësaj marrëveshjeje është ndalimi i migracionit të paligjshëm, por kryesisht të emigrantëve të paligjshëm nga vendet e treta që hyjnë nëpërmjet kufijve që Shqipëria ndan me vende të BE-

së. Të mos harrojmë që problematikën më të madhe, në fakt, e kemi pasur në kufirin e gjelbër në Jug që kemi me Greqinë. Këtë fakt e kemi thënë dhe dihet.

Besoj se pyetja ishte për azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së. Unë dua të them që trendi i këtij fenomeni filloi në vitin 2015 me flukset e mëdha migratore që pushtuan të gjithë Europën. Duke u kthyer në trend, për shkak të një informacioni të gabuar, të padijenisë apo jo informacionit të saktë të qytetarëve shqiptarë, të gjithë rendën për të migruar në mënyrë të paligjshme dhe për të menduar se kështu do të mund të gjenin një vend pune apo mundësi tjetër.

Ministria e Brendshme fokusin e saj sigurisht e ka pasur në parandalimin e migracionit të paligjshëm, sepse kjo është detyrë funksionale e ministrisë së Brendshme, Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, në mënyrë që të mundemi të rregullojmë lëvizjen e shtetasve shqiptarë në respektim të kriterëve të lëvizjes në zonën Shengen. Patjetër që ka pasur një reagim dhe një lloj kontrolli të fortë kufitar. Besoj se do të merren edhe nisma të tjera nga qeveria, sepse migracioni është një fenomen social dhe i lidhur me sigurinë. Unë do të jap disa statistika.

Nuk më erdhi mirë kur këtu u tha që janë 200 mijë azilkërkues shqiptarë. Duhet të kemi përgjegjshmërinë për të informuar saktë qytetarët shqiptarë. Çdo person që ka një autoritet dhe pozicion publik duhet ta bëjë këtë në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme. Të largohemi nga shifrat dhe lajmet e rreme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lini të mbaroj. A mund të mbaroj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të vazhdoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, a mund të vazhdoj?

Genc Pollo – Po, por me sugjerimin që mundësisht ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rovena Voda – Jo, jam shumë modeste. Ju thashë që pavarësisht se kjo nuk ka lidhje me marrëveshjen, unë do të përgjigjem, sepse ju jeni deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe ju respektoj.

Në vitin 2016 kanë qenë 32465 azilkërkues, në vitin 2017 kanë qenë 25745, në vitin 2018 kanë qenë 19620. Pra, po të vëmë re trendin, në vitin 2015 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, janë azilkërkues. Në vitin 2015 kanë qenë 67950. Pra, po të shikojmë trendi tregon që tani kemi 25% të azilkërkuesve që kemi pasur në vitin 2016. Kjo do të thotë që qytetarët shqiptarë nuk e shikojnë më rrugën e azilkërkimit të pabazuar si një rrugë për të shkuar dhe për të migruar.

Sigurisht, këtu po bëhen përpjekje nga qeveria për të krijuar mundësi të reja punësimi e të tjera, por edhe për t'i orientuar qytetarët, sepse lëvizja e lirë dhe migrimi janë të drejtat e tyre. Shqiptarët kanë zgjedhur historikisht rrugët e migracionit të ligjshëm. Çdo njeri ka të drejtë ta bëjë këtë. Me këtë fenomen janë përballur disa vende të BE-së, si Kroacia, Rumania, Bullgaria. Nuk e di çfarë mund të themi për to. Unë jam shumë e lumtur dhe krenare sot të them që trendi i azilkërkimit ka ardhur në ulje. Këto janë shifra zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse kalojnë ...

Genc Pollo – Zonja Voda, a mund të flasim?

Rovena Voda - Po. Këto janë shifrat. Unë i dhashë

Genc Pollo – Që të qëndrojmë te çështjet, se po shkuam më shumë nuk përqendrohemi dot dhe e humbet koherencën biseda. Ju thatë se shoqëria shqiptare, sipas jush, nuk e sheh më të ardhmen e vet tek emigracioni, në një masë të madhe.

Faktet që ne dimë nga zonat zgjedhore, nga Shqipëria, nga palët e dyta, palët e treta dhe nga palët e huaja, e kundërshtojnë këtë që thatë ju. Shifrat e migracionit kanë pasur fluktacionet e tyre. Kjo është normale, por muajt e fundit ka një shqetësim nga vendi më i madh i BE-së, nga Gjermania për 3 mijë kërkesa azili, që kanë qenë më së shumti ekonomike dhe politike. Kjo është një gjë që sa po vjen dhe po përsëritet. Më parë ka qenë Franca, që e ka ngritur këtë problem. Në muajt e fundit, sipas informacioneve, këtë problem e ka Gjermania dhe ky është një shkak që Komisioneri i Zgjerimit, zoti Hahn në vizitën e fundit në Tiranë, në deklaratën që bëri pas takimit me qeverinë, veçoi: *unfounded asylum obligations*. Ai nuk kishte interes të përmendte gjëra që nuk shkojnë, për sa kohë janë të impenjuar për rekomandimin pozitiv. Pra, ky është një shqetësim i madh dhe nga sa dimë (po i kthehem përvojës sonë para se të gjykojmë me fjalët e të tjerëve), masivisht rinia, shtresat e mesme dhe profesionistët duan të emigrojnë në vendet e pasura të BE-së. Ka dhe ka pasur edhe në vende të tjera fenomene të ngjashme, por tek ne ky problem është më akut.

Kështu, pohimi optimist më duket i pabazë, prandaj edhe shifrat duhet t'i paraqisni me metodologjinë për atë që përfaqësojnë. Nëse janë vetëm ata që kërkojnë strehim, nëse janë vetëm ata që shkojnë atje, rrinë dhe e thyejnë afatin 3-mujor, pra kalojnë në shkelje të normave

të liberalizimit të vizave. Duhet të jeni më specifike në mënyrë që komisioni të informohet në mënyrë objektive për këtë shqetësim të madh. Është një shqetësim për vendet europiane, por është edhe shqetësimi i boshatisjes së vendit tonë, se në fund të fundit, kush do ta bëjë ekonominë dhe të tjerat këtu.

Urdhëro, Jorida!

Jorida Tabaku – Kisha një koment në lidhje me shifrat, meqenëse edhe unë, edhe zoti Bumçi iu referuam.

Zonja zëvendësministre, thatë se në vitin 2015 në mënyrë të çuditshme, të pashpjeguar, pa asnjë lidhje me ndonjë proces tjetër, shqiptarët të painformuar, filluan të emigrojnë. Kjo mund të kishte të ndodhur në vitin 2009, kur filloi procesi i liberalizimit të vizave, por asnjëherë në vitin 2015.

Sipas të shifrave zyrtare të Eurostatit, të llogaritura dhe të hapura një më një për çdo vit, del se ka pasur 200 mijë kërkesa për azil ekonomik nga Shqipëria për të gjitha vendet e BE-së. Unë përmenda Gjermaninë, që e ka shqetësim kryesor, përmenda Holandën. I kemi takuar së bashku, deputetë demokratë dhe socialistë në të njëjtën tryezë dhe ata na kanë thënë këto shqetësime. Këto janë arsytet e tyre pse ata nuk e rekomandojnë hapjen e negociatave.

Kemi qenë pikërisht, unë zonja Gjoshë, dhe kolegët e tjerë, që nuk janë sot këtu, kur i kemi dëgjuar që na kanë thënë se ky është shqetësimi kryesor i tyre. Kështu, unë besoj se kur u referoheni shifrave dhe jeni shumë e lumtur, kjo do të ishte në rastin kur ky nuk do të kishte ndodhur si fenomen. Në rastin kur ne renditemi si Siria, dhe vendet ku ka luftë, unë nuk besoj se ka vend për lumturi apo për kënaqësi dhe për ndonjë lloj tjetër emocioni pozitiv. Këtu po diskutojmë për kërkesat për azil, duke pasur parasysh shkaqet ekonomike. Ky është shkaku kryesor i kërkesave të të gjithë azilkërkuesve. Prandaj është bërë shqetësim. Ky nuk ka qenë shqetësim para vitit 2015. Ne, që kemi lexuar raportet e BE-së ndër vite, që nga viti 2009, kemi parë se nuk ka qenë asnjëherë shqetësim çështja që po ngrihet sot.

FRONTEX-i edhe në analizën e riskut që ka bërë në vitin 2017, e vendosi në mënyrë të veçantë theksin te siguria e kufijve në Shqipëri. Është e vërtetë ajo që thoni ju që është rritur dhe është përmirësuar, si dhe ka pasur më shumë probleme për ata që vijnë nga vendet e Botës së Tretë në Shqipëri për të kaluar në vendet e BE-së, por nga ana tjetër, është rritur shqetësimi për azilkërkuesit shqiptarë.

Unë besoj se me më shumë modesti Shqipëria mund ta merrte dhe ta trajtonte me prioritet këtë çështje. Unë e kuptoj që po ndodhin shumë gjëra, që është hapur në shumë fronte dhe ka degraduar në shumë fronte plotësimi i të gjitha kriterëve dhe prioritetëve, por

kjo çështje që është bërë një problem për shumë vende anëtare të BE-së, duhej marrë me më shumë seriozitet nga qeveria. 200 mijë është shifra së cilës iu referua zoti Bumçi, sipas Eurostat-it, së cilës i janë referuar të gjitha institucionet zyrtare.

Genc Pollo – Zonja Voda!

Rovena Voda - Unë fola me shifra dhe thashë, se gjithçka është në rënie. Kështu, aty ku është për të thënë një fjalë të mirë, duhet ta themi.

Tjetra, për sa i përket shqetësimit që po ngre Gjermania dhe që e ka pasur Franca, siç jeni ju në kontakt, edhe unë, si zëvendësministre, që mbuloj fushën e migracionit dhe të azilit, jam në kontakt me ambasadat e tyre (franceze, gjermane etj.) në Tiranë. Unë mund të them se në vitin 2018 në Gjermani është shënuar numri rekord më i ulët i azilkërkuesve në vitet e fundit, nga statistikat, që edhe ne sigurisht i marrim nga Eurostat-i.

Me Francën kemi shtruar urat e një bashkëpunimi shumë të mirë. Ata janë shumë të kënaqur. Sigurisht, ka shumë për të bërë, por bashkëpunimi është në një nivel shumë të mirë dhe shifrat edhe atje kanë ardhur duke u ulur.

Jo më larg se para 2 javësh unë pata një takim (meqë zonja Tabaku më përmendi sirianët), me drejtorin e Zyrës për të Huajt në Ministrinë e Brendshme të Belgjikës. Vite më parë shqiptarët renditeshin të dytët në këtë aspekt, por tashmë (në vitin 2018), ata zënë vendin e dhjetë. Të shkosh nga vendi i dytë në vendin e dhjetë, më vjen keq, por kjo flet jo vetëm për punën e mirë të Policisë Kufitare në respektim të lëvizjes së shtetasve shqiptarë drejt zonës së vendeve Shengen, por unë mendoj gjithashtu, se shqiptarët nuk e shohin më migracionin e paligjshëm dhe azilkërkimin, si rrugën e tyre për të krijuar një jetë jashtë kufijve të territorit të RSH-së.

A mund të vazhdoj me përgjigjen e pyetjeve? Më pas, kolegët deputetë mund të vijojnë më pas me diskutimet.

Pyetja e dytë, ishte për armët, municionet...

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Këtë e ka marrëveshja.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Po. A mundem?

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Aldo Bumçi – Tek ne nuk ka pasur fluks migrator. Pse bëhet kjo marrëveshje? Kjo ishte pyetja.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Çfarë do të thuash për armët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo – Zonja Gjoshaj, e ka fjalën për një koment!

Më pas, për përdorimin e armëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klajda Gjoshaj – Ne do të bëjmë një seancë dëgjimore dhe do të kërkojmë edhe shkresa zyrtare, madje unë do të shkoja më tej, mendoj t'i kërkon Komisionit Europian raportin për sa i përket çështjes së azilkërkuesve, sepse siç ju thashë, ai raport do të diskutohet në këshillin e radhës në qershor 2019 dhe ka një rëndësi të veçantë. Nuk e theksova dhe nuk pyeta kot për këtë.

Edhe për çështjen e numrave, sepse ju thoni disa shifra, por ju i keni shifrat (s' do të thosha të manipuluara), por që varen shumë nga metodat që ju përdorni dhe se për cilët qytetarë bëhet fjalë. Ata që sot janë në dyert e BE-së dhe presin akoma të marrin azilin apo të gjitha kërkesat, që kanë mbërritur, përveç atyre që janë pranuar, apo që nuk janë pranuar.

Unë dua të ritheksoj edhe një herë atë, që ka thënë komisioneri Hahn vetëm 2 javë më parë, sepse është e lehtë të flasim me krenari. Jemi shumë krenarë, e kemi ulur shifrën me 1 mijë persona.

Komisioneri shpreh shqetësim për numrin ende të lartë të aplikimeve të pabazuara për azil të qytetarëve shqiptarë në disa shtete anëtare të BE-së. Ai kërkon që shkaqet themelore të trajtohen dhe të vazhdojë bashkëpunimi me qeveritë e vendeve anëtare.

Pyetja ime e dytë, nuk ishte vetëm për numrin, por ishte nëse keni bërë ju një analizë të shkaqeve se përse kërkojnë të largohen qytetarët shqiptarë dhe cilat janë hapat që ju do të ndërmerri për ta frenuar këtë fenomen? Këtë pyetje e kam bërë prej shumë kohësh dhe askush nuk arrin të bëjë një analizë, si dhe nuk i jep një përgjigje. Nëse nuk doni të na e jepni neve, zonja Voda, do t'ia jepni KE-së, sepse çështja e negociatave të Shqipërisë sot po mbahet peng pikërisht nga kjo çështje madhore. Është Franca, Gjermania, Belgjika, Suedia, dhe një sërë shtetesh, që e kanë ngritur këtë shqetësim. Të mos harrojmë se Shqipëria nuk është një vend në luftë. Kjo do të thotë që këtu ka problematika të tjerat për të cilat qeveria duhet të japë një përgjigje zyrtare, pse ndodh kjo dhe cilat janë hapat që ju do të ndërmerri. Nuk mund të kalohet me faktin që ju jeni krenarë, se është ulur numri i azilkërkuesve me 1000. Nëse do të mendohet në këtë mënyrë, është e pafalshme. Nuk do të gjejmë asnjëherë ndonjë zgjidhje. Ndaj, megjithëse i dhatë gojarisht shifrat sot në komision, unë do të kërkoja që t'i dërgoni

edhe me shkrim, zyrtarisht nga ju, raportin, që ju do t'i dërgoni KE-së për çështjen e azilkërkuesve.

Faleminderit!

Rovena Voda - Unë e theksoj edhe një herë. Besoj se isha shumë transparente. Këtu nuk po flasim për 1000 veta, por po flasim për 25% rënie të numrit në 4 vjet. Nëse do ta shikonim edhe grafikisht, patjetër do të ishte impresionuese.

Për sa i përket shqetësimit që ka ngritur komisioneri që ju përmendët, unë nuk e kam dëgjuar këtë deklaratë të tij, por dua të them edhe një herë se nga kontaktet që unë kam pasur me ambasadat dhe kjo është detyra ime, si zëvendësministre që mbuloj emigracionin dhe azilin që të jem në kontakt me ta, unë nuk e kam këtë shqetësim kaq të mprehtë dhe kaq të madh.

Nëse ju e lidhni këtë me marrëveshjen, kjo nuk ka fare lidhje. Mjafton të shihni statuset zyrtare të delegacionit të BE-së në *Twitter* dhe në *Facebook*, ato e kanë komplimentuar qeverinë për firmosjen e kësaj marrëveshjeje.

Për sa u përket vendeve të tjera, është e vërtetë. Maqedonia është vendi i dytë, që e ka finalizuar marrëveshjen, të paktën nga kontaktet që kam pasur me kolegët e mi maqedonas të Ministrisë së Brendshme. Maqedonia është vendi i dytë që e ka finalizuar marrëveshjen. Nuk e di nëse e ka nënshkruar apo jo. Do të kalojë shumë shpejt për miratim në Kuvendin e Maqedonisë. Me të njëjtin ritëm po ecin edhe Mali i Zi, edhe Serbia.

Të mos harrojmë që Serbia, Bosnje-Hercegovina kanë edhe problemet e tyre. Kështu, nuk po futem në çështjet politike e në të tjerat.

Për sa i përket problemit që do të kenë kompetenca ekzekutive, thashë se kjo është një marrëveshje, e cila funksionon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë e ngritët si shqetësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, më lër të përgjigjem dhe pastaj bëj komentet! Unë nuk ju ndërpreva.

Aldo Bumçi – Unë po them se ky është lajm i mirë, sepse ju keni dështuar dhe po vijjnë europianët këtu.

Rovena Voda - Jo, kështu siç e përkthen ti, është shqetësim. Tani, të lutem më lër ta mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merreni fjalën më pas! Shumë bukur! Të flasim me radhë!

Genc Pollo – Nëse mbaruat, zonja Gjoshë, ju kërkoi që raportin që ju i dërgoni Brukselit për këtë çështje, t’ia dërgoni edhe komisionit, nëse është e mundur.

Rovena Voda - Nuk e di si janë rregullat, por besoj se kërkesa duhet bërë me shkrim.

Genc Pollo – Kjo nuk është e detyrueshme, por mund të na e sillni me *e-mail*. Nëse e doni kërkesën me shkrim...

Rovena Voda - Patjetër, nëse bëni një kërkesë me shkrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo – Dakord.

Atëherë, zonja Gjoshë do ta formulojë kërkesën pas mbledhjes.

Rovena Voda - Patjetër.

Për sa i përket pjesës së marrëveshjes, unë desha të them se kjo marrëveshje do të kalojë shumë shpejt edhe në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi.

Për sa u përket detyrave dhe kompetencave të anëtarëve të ekipit, në nenin 4, pika 2 është shkruar:

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të vazhdoj, të dashur deputetë?

“Anëtarët e ekipit duhet të respektojnë ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë.”

Kjo është shkruar në pikën 2 të nenit 4 të marrëveshjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Po pikën 5, për armët, a e ke lexuar?

Rovena Voda - Ata janë të detyruar vetëm në bazë të një plani operacional, për situata ekstreme dhe në praninë e anëtarëve tanë të Departamentit tonë të Kufirit dhe të Emigracionit, që t’i përdorin ato...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata mbajnë përgjegjësi në bazë të legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë. Në qoftë se ata e përdorin në një operacion për shkaqe operationale, sigurisht, kjo është tjetër gjë. Ashtu sikurse, edhe oficerët tanë të Kufirit dhe të Emigracionit.

Jorida Tabaku – Po lexoje pikën 5!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo – Urdhëro, zoti Bumçi!

Aldo Bumçi – E para, vendet ku kanë kaluar flukse të mëdha migratore janë: Maqedonia, Serbia, Bosnja dhe më tej Hungaria dhe nuk është Shqipëria. Marrëveshja e parë

bëhet me Shqipërinë. Kjo do të thotë që kjo marrëveshje nuk ka lidhje me flukset migratore, por ka lidhje me krimin.

Ajo që unë dua të theksoj është kjo: të gjithë e mbajmë mend se si KE-ja, Delegacioni European në Shqipëri nuk thoshte asnjë fjalë për krimin dhe për drogën. Kjo ishte një situatë anormale. Shqiptarët e shihnin dhe Europa nuk fliste. Në një hark të shkurtër kohor, Europa jo vetëm i përfshiu këto dukuri në të gjitha raportet, që ne jemi tashmë një vend hyrës i drogave të forta, bazë operationale e krimit të organizuar rajonal. Gazetat europiane flasin për narkoshtetin. Sot nga një situatë, kur para pak vitesh nuk thuhej asnjë fjalë, sikur nuk kishte krim dhe drogë, Europa po na sjell policinë e saj që të veprojë me forcë në territorin shqiptar, sikur të ishte policia shqiptare. Të gjithë e kuptojnë se si ka ndryshuar tërësisht njohja e realitetit. Më vjen mirë dhe ky është një lajm i mirë, që Europa nuk po mbyll sytë. Arsytet e mbylljes së syve janë nga hallet e tyre, deri te pagesat.

Sot Europa, e vetëdijshme për krimin e lidhur me qeverinë këtu, ka sjellë policinë e saj, që ajo të veprojë si policia shqiptare, duke përdorur forcën dhe të veprojë në 360 gradë brenda territorit shqiptar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër nuk je dakord, sepse je zëvendësministre e një ministrie, ku drejtuesit e saj janë në kërkim. Ky është një lajm shumë i mirë, sepse Europa ka mësuar se kush është Edi Rama dhe se çfarë narkoshteti ka ndërtuar në Shqipëri.

Faleminderit!

Rovena Voda - Për sa u përket flukseve ...

Genc Pollo – Të mbajmë radhën e diskutimeve!

Zonja Mesi, do ta kërkon fjalën prapë?

Rovena Voda - Ai hodhi baltë mbi marrëveshjen dhe mbi arsyen pse e po miraton Shqipëria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kjo është baltë.

Kjo është një marrëveshje statusore dhe marrëveshje tip me të gjitha vendet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, unë të them një gjë. Në Maqedoni aktualisht, prej më shumë se 1 viti janë 164 forca të huaja policore, që përdorin armë, që nga koha e flukseve migratore. Unë nuk doja, por po e jap këtë shifër. Është e vërtetë që tek ne nuk kanë qenë. Kjo do të thotë se shteti

maqedonas paska rënë. 164 forca policore në Maqedoni, por unë do të jap disa statistika, zoti Bumçi.

Në vitin 2016 flukset migratore nga vendet e treta drejt Shqipërisë kanë qenë 915, në vitin 2017 kanë qenë 1049, në vitin 2018 ka qenë 6894, prandaj mos të përhapim gjëra që nuk kanë bazë dhe të themi se nuk ka flukse migratore Shqipëria.

Ne e dimë situatën tepër të rënduar në vendet e Lindjes së Mesme, flukset e mëdha që vazhdojnë të vijnë në Turqi, Greqi etj. dhe Shqipëria nuk ka ngelur dot, si çdo vend i Ballkanit Perëndimor pa u prekur nga këto flukse.

Këto shifra ne i raportojmë në Komisionin European, bëjmë raport dyjavor për flukset e paligjshme të emigrantëve, si dhe te Frontex-i. Kjo ishte për të krahasuar Shqipërinë me vendet e tjera.

Një pyetje tjetër ishte e zonjës Tabaku, se sa agentë do të jenë, pra disa hollësi lidhur me marrëveshjen.

Unë e ceka pak më parë dhe kjo lidhet pak me pyetjen e zonjës Gjoshë për implementimin e marrëveshjes. Numri i agentëve apo operacionet janë çështje operationale, që, pas hartimit të marrëveshjes së punës, do të vendosin standardet bazë të bashkëpunimit të Frontex-it me oficerët tanë të kufirit dhe migracionit, më pas do të bëhen plane operationale, por rast pas rasti.

Në planin operacional, në mënyrë të detajuar, përshkruhet se sa do të jenë nga departamenti ynë i kufirit dhe migracionit, sa do të jenë nga FRONTEX-i, zona ku do të zhvillohet e të tjera detaje, se unë nuk jam eksperte e kësaj fushe.

Pra, në bazë të planit operacional të detajuar do të përcaktohen edhe këto detaje.

Për sa i përket vonesës, se një nga pyetje ishte se ka kaluar në KM në maj 2018, kjo për shkak se ishte një marrëveshje shumë e madhe dhe këtë marrëveshje edhe në vendet e tjera, me sa di unë, do ta firmosë vetë komisioneri në Komisionin European, zoti Dimitris Abramopolus, dhe të vetmin moment që të ishin të dyja palët për të firmosur, dhe ministri i Brendshëm, edhe komisioneri, ishte pikërisht data 5 tetor, kur u firmos kjo marrëveshje në ministerialin e ministrave të Brendshëm të Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Tiranë, që është bërë nën kryesinë e presidencës austriake. Kjo është arsyeja e vonesës.

Për sa i përket planit për parandalimin ...

(Diskutime pa mikrofon)

Me urdhër të Kryeministrit, që në maj apo në fillim të qershorit, se datën nuk e kam të fiksuar, është ngritur një grup ndërminstoror pune për të hartuar strategjinë kombëtare të migracionit.

Në fakt, Shqipëria, në 2004-2009 ka pasur një strategji, pastaj pas vitit 2009-2010 ka pasur vetëm profile të migracionit të hartuara nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit. Një nga kërkesat, gjithashtu, rekomandimet e progres-raportit e KE-së (jo për Shqipërinë, por për të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, duke qenë se migracioni ka qenë një nga shtyllat e BE-së dhe një nga sfidat e saj) ka qenë hartimi i kësaj strategjie.

Këtë grup pune e kam kryesuar unë si zëvendësministre e Brendshme. Anëtarë kanë qenë të gjithë përfaqësuesit (besoj se kjo është një gjë e mirë) e të gjitha ministrive të qeverisë shqiptare dhe, sigurisht, kemi pasur mbështetjen edhe të ekspertëve ndërkombëtarë, kryesisht të IOM-it, Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin, që ka edhe ekspertizën më të madhe. Draftin e kemi përfunduar dhe e kemi konsultuar, jemi gati të reflektojmë konsultimet dhe sugjerimet e të gjitha ambasadave, pra të gjithë vendeve të BE-së deh delegacionit të BE-së.

Unë mendoj se miratimi i kësaj strategjie kombëtare (ne kemi dashur të shkojmë më larg, jo thjesht menaxhim, por qeverisjen e migracionit) nuk do ta japë impaktin në një muaj apo në gjashtë muaj, por në terma afatgjatë patjetër do të jetë një vlerë e shtuar.

Faleminderit!

Genc Pollo - Faleminderit!

Nuk është se vuajmë shumë nga mungesa e strategjive, me thënë të drejtën, apo mënyrën e hartimit të tyre, por çështja është te zbatimi dhe të rrethanat që i përmendën kolegët.

Fjalën e ka zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Përsëndetje, zonja Voda!

Nuk doja ta ktheja në debat dhe nuk dua të komentoj mbi atë që u tha nga kolegët.

Ajo që dua të pyes është për çastin kur këta persona kanë arritur në Shqipëri.

Zonja Tabaku e përmendi se kjo është miratuar dhe pastaj marrëveshja është bërë me 5 tetor, që do të thotë se ardhja e këtij dokumenti në komisione është formale. Ju faktikisht nuk doni miratimin tonë dhe kjo bëhet në një mënyrë shumë formale.

Në dijeninë tonë, disa nga agentët e Frontex-it janë në Shqipëri, në momentin që flasim.

Në këtë kuadër do të doja të dija se pse jeni këtu, duke qenë se e keni marrë këtë vendim?

Ky projektligj ka kaluar edhe në Komisionin e Jashtëm dhe nuk keni një rakordim me kolegët tuaj sepse zoti Hodaj në atë komision tha se ky është një projektligj apo një marrëveshje unike në rajon, kështu që ajo që sapo thatë për Maqedoninë është për t'u verifikuar.

Është e vështirë të flasim gjuhën tuaj, por edhe ju e keni shumë të vështirë të flisni gjuhën tonë, por ne nuk mund t'i anashkalojmë dot faktet. Nëse ka një shifër konkrete, e cila është në total, le të themi se kaq është totali dhe kaq është e ndarë ndër vite.

Këto shqetësime kisha unë.

Faleminderit!

Genc Pollo – Urdhëroni!

Rovena Voda - Faleminderit!

Unë dua t'ju them se kjo marrëveshje, në fakt, është hartuar dhe nënshkruar konform të gjitha parashikimeve. Ne kemi një ligj për marrëveshjet ndërkombëtare, të miratuar në vitin 2016 dhe çdo hap i kësaj marrëveshjeje nuk ka anashkaluar procedurën e parashikuar në këtë ligj. Kjo është një marrëveshje e firmosur dhe e hartuar në emër të Republikës së Shqipërisë. Për këtë marrëveshje fillimisht është kërkuar autorizim nga Presidenti i RSH-së në bazë të autorizimit për plotfuqi që lëshon Presidenti duke përcaktuar edhe emrat e grupit negociator. Më pas është vijuar me procedurën.

Kur finalizohet marrëveshja, ajo kalon për miratim. Disa prej jush keni qenë edhe anëtarë qeverie dhe e dini se kalon për miratim në KM dhe pasi kalon për miratim, firmoset nga të dyja palët dhe pastaj shkon në Kuvendin e Shqipërisë.

Kjo ishte jo për të shmangur parlamentin, por kjo është procedura e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Zoti Hodaj ndoshta nuk ka thënë “unike” në këtë sens, nuk besoj se ka thënë “unike” për rajonin. Nuk mund të komentoj se nuk kam qenë në atë komision, por në përgjegjësinë e plotë të zëvendësministres që mbulon fushën e azilit dhe të migracionit po them se kjo është një marrëveshje, e cila ka qenë një nga detyrat e BE-së, për t'u finalizuar dhe firmosur nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni nëse jam keqkuptuar në kthimin e përgjigjeve të mia. Është nder të jesh para një komisioni dhe të përfaqësosh dhe të mbrosh një projektligj dhe besoj se unë e bëj me shumë përgjegjshmëri.

Për sa i përket pjesës së agentëve, unë u ktheva pas në kohë dhe përmenda marrëveshjen e vitit 2009 me Frontex-in, që do të thotë se ne, që nga viti 2009, kemi prezentë agentë të Frontex-it, edhe në aeroportin “Nënë Tereza” po të shkosh sot ke agentë të Frontex-it, por sigurisht ata kanë një rol vëzhgues dhe konsultues atje.

(Diskutime pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Kam një ndërhyrje, zoti kryetar në lidhje me mënyrën se si duam t’i lexojmë gjërat. Sigurisht, shqipen mund ta përkthejmë në shqip, sikurse është e zeza në të bardhë, ose mund ta përkthejmë secili nga ne në gjuhën apo dëshirën e vet.

Nëse flasim për një marrëveshje midis RSH-së dhe BE-së për çështjet e kufirit detar dhe tokësor dhe duam ta përkthejmë si një marrëveshje ku BE-ja thotë se këtu ka drogë, ka krim e të tjera, kjo është në dëshirën e opozitës dhe nuk kam pse të ndërhyj, por ndërhyrja ime shkon në linjë me arsyetimin që duhet t’i lexojmë gjërat si duhet të lexohen dhe jo të keqinformojmë dhe të vazhdojmë të keqinformojmë.

Nga njëra anë ju thonë shqyr që po bëhet një marrëveshje e tillë dhe nga ana tjetër thonë se duam të aprovojmë një marrëveshje të tillë, por shteti shqiptar ka falimentuar, apo kuotoni dështim të shtetit shqiptar, që të jemi korrekt, ndërkohë që ne po flasim për marrëveshje standarde dhe jo të një tipi të veçantë.

Në lidhje me kërkesën për emigracionin, me kërkesat për azilantët, do të kërkoja (se ne këtu mund të rrimë gjithë ditën me pyetje dhe përgjigje pa pasur një statistikë të detajuar me kërkesë edhe të anëtarëve të opozitës, por edhe të pozitës), sigurisht, për kërkesa specifike, një raport të detajuar në lidhje me këto dy çështje që në fund të ditës janë çështje të rëndësishme, jo vetëm për ministrinë e brendshme, por për Shqipërinë dhe procesin e integritetit.

Në një seancë dëgjimore shteruese ose jo të thërrasim edhe anëtarë të Ministrisë së Brendshme apo edhe ministrin vetë për të raportuar, për të mbrojtur raportin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve tona.

Genc Pollo – Për këtë të fundit ramë dakord. Me vendim të komisionit (do ta hartojnë Klajda dhe pas mbledhjes do ta firmos unë) do të kërkojmë informacion nga Ministria e Brendshme për sa u tha.

Urdhëroni!

Viktor Tushaj - Faleminderit!

Unë vazhdoj t’i mëshoj shumë idesë së përafrimit të standardeve me BE-në. Ne duhet të kuptojmë të gjithë sot se BE-ja është e shqetësuar për mungesën e standardeve që ka Policia

e Shtetit, për korrupsionin e lartë që ka, për krimin e organizuar që komandon qeverinë dhe policinë, por edhe për shumë problematika të tjera.

Unë shfrytëzoj rastin e prezencës së zëvendësministres, do t'ju kërkoja ndjesë kolegëve, për të ngritur dy shqetësime të qytetit të Lezhës.

Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme sekuestruan 5 milionë e 200 mijë euro të një qytetari lezhjan dhe sot akoma në uebsajtin e Policisë së Shtetit është lajmi se kjo pasuri është sekuestruar, kur dërguesi i këtyre parave është një qytetar shqiptar me nënshtetësi suedeze, i cili ka sjellë gjithë dokumentacionin për mënyrën e sjelljes së këtyre parave në Shqipëri. Kjo tregon mungesën e profesionalizmit të specialistëve shqiptarë në verifikimin e gjithë kësaj situate.

Një çështje tjetër që tregon mungesën e profesionalizmit. Ka 10 ditë që është mbytur një peshkatar në qytetin e Lezhës, në grykëderdhjen e lumit Drin. Ajo që më shqetëson si deputet i Kuvendit, por edhe si anëtar i këtij komisioni, që kërkon standarde, është që ky përafrim legjislacioni të ndikojë në përafrimin e standardeve. Më shqetëson neglizhenca e Ministrisë së Brendshme. 10 ditë është braktisur familja në fatkeqësinë e saj, se forcat e ndërhyrjes së shpejtë jo vetëm shkojnë e bëjnë sehir atje, po ikin dhe nuk duan t'ia dinë, dhe familja është bërë gati të kërkojë ndihmë shtetit të Kosovës.

Ne duhet të kuptojmë se sot BE-ja është e shqetësuar për mungesën e standardeve, për mungesën e profesionalizmit për kontrollin e kufijve dhe për çdo që gjë që ka sot në Shqipëri.

Faleminderit!

Rovena Voda – Për sa i përket problemit të kufijve, e gjitha kjo nuk qëndron për një fakt shumë të thjeshtë. Ne ndajmë kufi të gjelbër, ne kemi flukset migratore nga një vend i BE-së, pra i bie që BE-ja ruhet nga BE-ja. Ne ndajmë kufijtë me Greqinë dhe andej i kemi edhe flukset migratore, kështu që i bie që BE-ja ta ketë problemin jo me ne, por e paska me shtetin grek. Kështu që duhet të jemi të kujdesshëm kur bëjmë këtë analizë.

Për sa i përket dy shqetësimeve që ngriti deputeti, të dyja rastet sigurisht që do t'i verifikoj. Më vjen çudi, sepse policia në çdo rast fatkeqësie për çdo qytetar shqiptar ka qenë gjithmonë e gatshme, qoftë në rast të humbjes së një të moshuari apo të një fëmije, apo të humbjes së jetës në një lum apo në det, kështu që patjetër do ta verifikoj.

Edhe për rastin e sekuestrimit, në qoftë se është vendosur sekuestro me vendim gjykatë, pra nuk është kaq e thjeshtë, patjetër që policia verifikon, pastaj bëhet kërkesa për të hequr masën e sekuestros. Pra, janë çështjet procedurale që ndikojnë në shpejtësinë e kësaj gjëje.

Faleminderit, për shqetësimet që ngritët! Do t'i shohim.

Genc Pollo – Me sa shoh, nuk ka më pyetje apo diskutime të tjera.

Çështjet e migracionit do të na angazhojnë edhe më tej, edhe pasi të marrim materialet informative nga ministria.

Ajo që vërej unë si pozitive është fakti se në fundvitin 2014, shifrat e azilkërkuesve shqiptarë rivalizonin me ato të Sirisë në luftë. Ministri i asaj kohe, Saimir Tahiri, dhe Kryeministri, Edi Rama, ky i fundit edhe sot, thoshin se nuk janë banorë të Shqipërisë, por janë shqiptarë, emigrantë prej kohësh në Greqi.

Më vjen mirë që kjo nuk u përsërit sot dhe u harrua këto vitet e fundit. Ndoshta në çdo situatë të vështirë duhet të përpiqesh të gjesh të mirën e gjësë.

Kalojmë tek akti që propozohet.

Si rregull, duhet të kishte folur edhe shefi i njësisë së përafrimit.

Në materialin e tij lexoj një frazë kyçe: “Nuk synon t’i përafrojë ndonjë akt të veçantë legjislationit europian”.

Puna jonë legislative për t’u afruar me standardet e Europës ka të bëjë me ligjet. E dimë se zbatimi është i vështirë. Ky nuk është ndonjë akt që sjell acqui në legjislationin e brendshëm. Kjo është një marrëveshje për situatat tona, problemet tona, ndoshta edhe problemet rajonale, por problemet tona, kështu që edhe retorika për integrimin europian, vend e pa vend, ndoshta duhet përdorur më me kujdes.

Si çdo marrëveshje edhe kjo përbëhet nga 2 nene.

Unë do të sillja në kujtesë vitin 2013. Një nga gjërat, kur Edi Rama, kryeministër sefte, ngjalli pëlqim në disa segmente të opinionit publik, ishte kur tha se do të pajtojë redaktorë për të nxjerrë aktet me cilësi drejtshkrimore të mirë të gjuhës shqipe.

Në fakt, kam vuajtur gjithë kohës dhe kjo m’u kujtua kur pashë ratifikimin e marrëveshjes “statusore”. Status është gjendja e një diçkaje dhe “statusore” është një mbiemër i sajuar, kurse statuti është akti normues i një organizate, si Kushtetuta, si Rregullorja apo gjëra të tjera. Prandaj habitem se pse e keni vënë “statusore”, si një neologjizëm i sforcuar, dhe fjalën normale “statutore”, që do të kishte kuptim juridik dhe gjuhësor në këtë rast e keni shmangur.

Ndoshta është edhe pyetje retorike dhe nuk e di a na e lejon teknika legislative që ta korrigjojmë.

(Diskutime pa mikrofon)

A mund ta korrigjojmë? Marrëveshja është e nënshkruar dhe nuk di a ka mundësi të ndërhyjë në tekstin e marrëveshjes Kuvendi.

Sepse, siç thotë kolegja, në rast se duam pastërtinë e gjuhës shqipe, duhet ta kthejmë që të rinëshkruhet e korrigjuar.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zoti kryetar!

E kemi analizuar dhe jemi ndalur pikërisht edhe në këtë çështje. Në vlerësimin tonë titulli është i saktë. Po i referohem nenit 54 të Rregullores përkatëse të BE-së, e cila është “Status agreement”, pra është “Marrëveshja statusore”, nuk është “Statutory agreement” që do të përkthehej “Marrëveshje statutore”, pra është marrëveshje e statuseve.

Pra, në vlerësimin tonë, por e vendosni ju, është i saktë termi “statusore” dhe jo “statutore”.

Mirela Kumbaro – Për sa i përket mbiemrit “statusor”, nuk është i sforcuar si mbiemër, por respekton të gjithë rregullat e sintaksës dhe të morfologjisë shqipe. Nëse rrënja do të kishte të bënte me statutin, do të ishte statutore, po duke qenë se ka të bëjë me statusin është statusore. Kështu respektojmë edhe angazhimin e marrë në fillim të mandatit të vitit 2013.

Genc Pollo – Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë me këtë votim e miratojmë marrëveshjen “statusore”, sipas jush.

Për mbledhjet e ardhshme do të mbetemi në kontakt.

MBYLLET MBLEDHJA